



MUZA COMPETITION

GUIDË APLIKIMI FAZA 1

“MUZA COMPETITION” është një projekt i ndërmarrë nga Unioni i Bashkive Shqiptare në Rajon në kuadër të Tiranës si Kryeqytet Europian i të Rinjve 2022, i cili përfshin aktivizimin e të rinjve pasionantë dhe profesionistë, në rrijetëzimin e elementeve etnografikë në fushën e fashion-dizajnit. Projekti i dedikohet të rinjve nga moshë 18-35 vjeç nga gjithë qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor, për t’u ofruar atyre një spektër më të gjerë mundësish profesionale që synojnë nxitjen e punësimit në ekonominë krijuese, nxitjen e krijimit të bizneseve start-up në këtë fushë, apo zgjerimin e bizneseve ekzistuese.

“MUZA COMPETITION” do të shërbejë si një hub për ekonominë krijuese dhe një vend për mundësi të reja biznesi, shkëmbim dhe bashkëpunim, ide dhe zgjidhje, promovim dhe prezantim të risive më të fundit. Qëllimi ynë është të mbështesim potencialin e mendjeve të reja krijuese, për të nxitur interesin e tyre për trashëgiminë kulturore, duke paraqitur sinergjinë midis tendencave bashkëkohore të modës dhe elementeve tradicionale.

Tani është koha për të plotësuar dokumentat për të aplikuar dhe për të hyrë menjëherë në punë për të dërguar të gjitha skicimet **deri më 4 Prill, ora 10:00 AM**.

Kriteret për aplikim janë si më poshtë:

1. Të rinj të moshës 18-35 vjeç nga qytetet shqipfolëse të rajonit të Ballkanit Perëndimor;
2. Dorëzimi i skicave me veshjet të cilat duhet të përmbajnë si tematikë kryesore elemente të etnografisë dhe trashëgimisë kulturore të qyteteve të ndryshme nga rajoni shqipfolës, duke u bazuar në specifikat e detajuara si më poshtë:
 - Një portofol me një minimum prej **15 skicash** të veshjeve për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit (maksimumi 20) në format A4. Për çdo skicë, ju duhet të përshkruani shkurt materialet që mendoni të përdorni për realizimin e saj.
 - Dizajnet tuaja do të vlerësohen në disa kategori; përdorimi i elementëve të trashëgimisë kulturore, metodat e përdorura për prodhimin e dizajneve, kreativiteti dhe origjinaliteti, qëndrueshmëria, tregtueshmëria.



- Çdo veshje duhet të jetë veshje komplet.
- Këpucët dhe aksesorët nuk kërkohen të dizenohen, por do t'ju duhen për të siguruar këpucë/aksesorë për koleksionin tuaj kur të arrini në fazën e tretë finale.
- Krijimet duhet të jenë origjinale dhe që nuk janë publikuar apo përdorur më parë.
- Asnjë veshje **nuk kërkohet të prodhohet** në fazën e parë dhe te dytë të aplikimit.

Dokumentat që ju kërkohet të paraqisni:

1. Kartë identiteti të aplikantit;
2. CV
3. Formulari i aplikimit sipas formës së kërkuar në faqen e aplikimit;
4. Dorëzimi i 15 skicave të veshjeve për të treguar konceptin tuaj fillestar të dizajnit (maksimumi 20).

Kur dorëzoni dokumentat për aplikimin tuaj duhet të keni parasysh se:

1. Të gjitha dokumentat duhet të plotësohen në gjuhën shqip ose anglisht.
2. Të gjithë dokumentat si më lart duhet të dorëzohen fizikisht dorazi osë me anë të postës në zyrat e Unionit të Bashkive Shqiptarë në Rajon në adresën **Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës, Kati 2-të, Zyra 18.**
3. Afati i fundit për aplikime është e dita e Hënë, **4 Prill 2022** në orën 10:00 AM (GMT+1).
4. Çdo aplikim i marrë pas afatit të konkursit nuk do te pranohet.
5. Pas dorëzimit të aplikimit, do të merrni një konfirmim me email.
6. Pas dorëzimit, ekipi mund të kontaktojë aplikantët për informacione të mëtejshme.
7. Ju lutemi vini re se **NUK** do të jeni në gjendje të ndryshoni aplikimin tuaj pasi ta keni dorëzuar.